



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 49, datë 11.12.2020

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE
RENDITJES SË KANDIDATËVE TË LEJUAR PËR VENDIN VAKANT NË
GJYKATËN KUSHTETUESE**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të neneve 229, 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo, e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 28.08.2018, rishpallur në datën 21.08.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARE


Vitore TUSHA

ANËTARE

Miranda ANDONI


ANËTARE

Arta MARKU


ANËTARE

Fiona PAPAJORGJI


ANËTAR

Ludovik DODAJ


ANËTARE

Saida DOLLANI




Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2020

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302